

Vendim nr. 233 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GËZIM GURI**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 67, datë 09.07.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; nr. 398, datë 01.04.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2021-25, datë 08.01.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 dhe vijues të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe shtetasi P.V. janë akuzuar se në datën 14.03.2002, në mjediset e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Burrel (*IEVP, Burrel*), ku vuanin dënime të rënda me burgim, kanë sulmuar me grushte dhe me një mjet mprehës dy të dënuar të tjerë, ku si pasojë ka gjetur vdekjen shtetasi F.K., ndërsa ka mbetur i dëmtuar shtetasi Q.H. Në kuadër të procedimit penal të regjistruar për këtë ngjarje, ata janë akuzuar për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë dhe në dëm të dy personave, të parashikuar nga nenet 79, shkronjat “d” e “dh” dhe 25 të Kodit Penal (*KP*), akuzë për të cilën dhe janë dërguar për gjykim.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 67, datë 09.07.2002, ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer në bashkëpunim, në dëm të dy personave, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 25 të KP-së, duke e dënuar atë me burgim të përjetshëm. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 27.08.2002, ndërsa ndaj tij nuk është paraqitur ankim brenda afatit ligjor.

3. Kërkuesi, në vijim, ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë ankim kundër vendimit për dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Pas disa gjykimeve në të tria shkallët, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 835, datë 25.09.2014, përfundimisht ka pranuar kërkesën e kërkuesit dhe pas kësaj ai ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 67, datë 09.07.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Mbi këtë ankim, sikundër edhe atë të bashkëpandehurit tjetër P.V., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 398, datë 01.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kurse për rekursin edhe të kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-25, datë 08.01.2021, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tyre, me arsyetimin se shkaqet e ngritura në to nuk ishin nga ato të parashikuara nga 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

4. Në datën 22.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 06.08.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

- 5.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtari kryesues i trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë duhet të hiqte dorë nga gjykimi, sipas nenit 17, shkronja “d”, të KPP-së, për shkak të lidhjes familjare me shefin e regjimit të brendshëm të IEVP-së, Burrel në kohën e ngjarjes, i cili për shkak të saj është pezulluar nga detyra, si dhe të lidhjes miqësore të tyre me të dëmtuarin Q.H. Njëanshmëria e gjyqtarit rezulton nga mospranimi i paarsyeshëm i kërkesës së kërkuarit për gjykimin e shkurtuar, ashtu dhe nga rrëzimi i kërkesës së tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, gjykim në të cilin nuk duhet të merrte pjesë.
- 5.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur*, pasi gjykata e shkallës së parë ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale në ngarkim të kërkuarit, pa e vënë në dijeni atë dhe mbrojtësin e tij, si dhe pa i dhënë kohën e nevojshme për t'u mbrojtur, në kundërshtim me nenin 375 të KPP-së dhe jurisprudencën kushtetuese. Edhe Gjykata e Lartë, ndonëse në rekursin e kërkuarit janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke i mohuar atij të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.
- 5.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i paarsyetuar, në kundërshtim me detyrimin e rrjedhur nga neni 142 i Kushtetutës dhe nenet 112, pika 3 dhe 383 të KPP-së. Ai nuk përmban asnjë analizë provash ose indicie që të fajësojë kërkuarin dhe as ndonjë arsyetim për papranueshmërinë e pretendimeve të tij, ndërsa ai në vijimësi ka mohuar autorësinë e veprës penale. Edhe gjykata e apelit ka riprodhuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, por duke mos arsyetuar për pretendimet e kërkuarit. Gjykata e Lartë, për mospranimin e rekursit të kërkuarit, ka arsyetuar në mënyrë të gabuar dhe në kapërcim të attributeve të dhomës së këshillimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe

2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja ”i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

8. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme në lidhje me përbërjen e trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë, si dhe cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata e shkallës së parë. Kolegji konstaton se këto pretendime kërkuesi nuk i ka ngritur as në ankimin në gjykatën e apelit, as në rekursin në Gjykatën e Lartë, duke i ngritur ato për herë të parë vetëm në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, për këto pretendime, ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

10. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe

publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-25, datë 08.01.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 06.08.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra pas 3 vjetësh e 7 muajsh. Në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, është paraqitur edhe shkresa nr. 1424/1 prot., datë 20.03.2024 e Gjykatës së Lartë, përmes së cilës kërkuesi është informuar për pamundësinë e vënies në dispozicion të dosjes gjyqësore, në kushtet kur ajo në datën 10.02.2021 i ishte dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Ndërkohë, bashkëlidhur kësaj shkrese, kërkuesit i është dërguar vendimi nr. 00-2021-25, datë 08.01.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, por nuk ka asnjë të dhënë për kohën kur ajo i është dorëzuar atij pranë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ku vijon të vuajë dënimin me burgim të përjetshëm.

12. Për sa më sipër, në kushtet kur kërkuesi është i izoluar për shkak të vuajtjes së dënimit me burgim të përjetshëm dhe nuk rezulton në mënyrë të qartë data e marrjes dijeni nga ai për vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se kërkesa duhet të konsiderohet si e paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe cenimin e standardit të vendimit gjyqësor, për sa u përket vendimeve të dhëna në të tria shkallët e sistemit gjyqësor. Referuar argumenteve të kërkuesit për këto pretendime që, në thelb, kanë të bëjnë me mosmarrjen ai përgjigje të arsyetuar për pretendimet e ngritura në gjykim, në ankim dhe në rekurs, Kolegji vlerëson që t'i trajtojë ato në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me ankimin efektiv dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me ankimin efektiv dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i paarsyetuar, ndërsa nuk përmban asnjë analizë provash ose indicie që fajësojnë atë dhe as ndonjë arsytim për

papranueshmërinë e pretendimeve të tij, ndërkohë që ai në vijimësi ka mohuar autorësinë e veprës penale. Edhe gjykata e apelit ka riprodhuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, por duke mos arsyetuar për pretendimet e tij. Kurse Gjkata e Lartë, duke mos e kaluar çështjen për shqyrtim në seancën gjyqësore, i ka mohuar atij të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Arsyetimi i saj për mospranimin e rekursit është i gabuar dhe në kapërcim të attributeve të dhomës së këshillimit, pasi në rekurs janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

15. Në jurisprudencën e saj Gjkata e ka vlerësuar të drejtën e aksesit si një nga aspektet e së drejtës për proces të rregullt ligjor, që nënkupton të drejtën e individit jo vetëm për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe për të marrë një përgjigje përfundimtare të arsyetuar prej saj, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket së drejtës së ankimit, Gjkata e ka vlerësuar si mundësi të çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë. Për ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi realizimi i saj si në aspektin formal/procedural, ashtu edhe atë substancial, ndërkohë që kërkesat procedurale të ankimit janë, përpara së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 23 datë 25.04.2023; nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 14, datë 05.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjkata është shprehur se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjkata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket funksioneve të kolegjit të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të rekurseve në dhomën e këshillimit, Gjkata ka pohuar se në rast se kolegji krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 59 datë 23.07.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Kolegji konstaton se gjatë procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë kërkuesi ka marrë pjesë rregullisht dhe është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur, duke pasur mundësi për të paraqitur kërkesa dhe për të debatuar në lidhje me provat, si dhe për të mbajtur qëndrim rreth faktit penal dhe akuzës së atribuar. Ndërkohë, në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket faktit penal të pranuar si të provuar, ajo gjykatë ka arsyetuar edhe për sa u përket provave mbi të cilat ka arritur në atë përfundim dhe konkretisht në deklaratimet e të pandehurve në gjyq, në hetimet paraprake dhe në seancën për caktimin e masës së sigurimit, në dëshmitë e të dëmtuarit nga vepra penale, Q.H., në dëshmitë e personave të pranishëm në ngjarje, shtetasit të dënuar S.D., dhe punonjësve të Policisë së Burgjeve, M.B., në aktin e ekspertimit mjekoligjor të datës 14.03.2002, si dhe në aktet e tjera shkresore. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka vënë në diskutim edhe pretendimet e kërkuesit për mohimin e autorësisë së veprës penale dhe për sa u përket deklaratimeve të bashkëpandehurit P.V. për marrjen ai përsipër të veprës penale, duke arsyetuar se nga analiza në tërësi dhe në unitet të veprimeve të të pandehurve, ka arritur në përfundimin se vepra penale është kryer nga të dy të pandehurit, pasi ata i kanë kryer veprimet në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe pasojë e tyre ka qenë dëmtimi i shtetasit Q.H., të cilin ata kanë synuar ta vrasin, gjë e cila nuk ka ndodhur për shkak se ky i fundit ka arritur të përballojë sulmin fizik të tyre, si dhe vdekja e shtetasit F.K., i cili nuk ka qenë pjesë e synimit të tyre, por ata nuk mund të mos llogarisnin reagimin e personave të tjerë në dhomë me të dëmtuarin Q.H., sikundër edhe se me veprimet e tyre dhe mjetin e zgjedhur (shufër metalike e mprehtë), mund të shkaktonin goditje edhe ndaj këtyre personave, sikurse kishte ndodhur në atë rast.

19. Kërkuesi e ka ankimuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështja në vijim është gjykuar nga gjykata e apelit, përpara së cilës kërkuesi ka parashtruar pretendimet e tij, duke pasur mundësi të debatojë në lidhje me to. Ndërkohë, në vendimin e saj, gjykata e apelit, ndërsa i ka vlerësuar të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me faktin penal të

provuar, i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit për mospasjen ai asnjë rol në krimin e ndodhur, duke arsyetuar se nga provat e administruara provohej se ai dhe i bashkëpandehuri P.V., në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë përgatitur sulmin ndaj të dëmtuarit Q.H. dhe, gjithashtu, kanë vepruar së bashku duke plagosur këtë të dëmtuar dhe duke i shkaktuar vdekjen shtetasit F.K. Po kështu, gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit tjetër të ngritur në ankim nga kërkuari në lidhje me vendimin e ndërmjetëm për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt, ndërsa për zgjidhjen e drejtë të çështjes ka qenë i nevojshëm debati gjyqësor dhe, për më tepër, kur në gjykim janë marrë prova të reja të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të saj, konkretisht dëshmitë e dy dëshmitarëve okularë në ngjarje, shtetasit S.D. dhe Q.Gj.

20. Për sa i përket procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, ai është vënë në lëvizje edhe për rekursin e kërkuarit. Rekursi i paraqitur nga kërkuari i është nënshtruar shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit, gjatë të cilit Kolegji Penal i asaj gjykate ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas atij kolegji, për sa u përket pretendimeve në rekurs që lidheshin me mospranimin e gjykimit të shkurtuar, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje, ndërsa arsyetimi i saj për këtë aspekt të procesit ishte i drejtë.

21. Nisur nga sa më lart, Kolegji vëren se kërkuari ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit në të tria shkallët e gjykimit, duke iu garantuar atij e drejta për të paraqitur pretendime në gjykim, sikundër edhe për të paraqitur ankim në gjykatat më të larta, duke marrë përgjigje nga ato. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj ka treguar mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Ajo gjykatë ka vlerësuar edhe provat që kërkuari pretendon dhe në analizë të të gjitha provave të administruara në gjykim, ka arritur në përfundimin për ekzistencën e faktit penal ku, mbi këtë bazë, ka zbatuar dhe ligjin penal ndaj kërkuarit. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar mjaftueshëm, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim nga kërkuari për mungesën e autorësisë në krim dhe për sa i përket vendimit të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sipas kompetencës së përcaktuar në nenin 433 të KPP-së, ka realizuar shqyrtimin paraprak edhe të rekursit të kërkuarit, duke analizuar dhe vlerësuar nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe pasi ka arritur në përfundimin se nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji dhe nuk gjejnë

mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, në përputhje me funksionin e tij, ka vendosur mospranimin e rekursit, pra moskalimin e çështjes për gjykim.

22. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk duket që kërkuessit të mos i jetë garantuar e drejta e aksesit dhe ajo e ankimit efektiv dhe as se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të mos kenë përmbushur standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, ndaj, për rrjedhojë, pretendimi i tij në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.